



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/

MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 26.12.2023
Rr.Tahir Zemaj, Nr.2.
Fushë-Kosovë

Bazuar në Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, UA Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe UA Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Komuna e Fushë-Kosovës ju fton në :

DISKUTIM PUBLIK

Për : **Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031**

Datë : 26.12.2023 deri më 09.01.2024

Vendi : Objekti i Komunës së Fushë Kosovës-(Holli i Komunës) dhe Drejtoria e Planifikimit Urban.

-Komuna e Fushë-Kosovës ka hartuar propozim **Planin Zhvillimor 2024-2032**, ku si bartëse e këtij procesi është Komuna e Fushë-Kosovës përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Urban në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera komunale, grupet punuese dhe kompaninë konsulente “**INSI**” SH.P.K me seli në Prishtinë.

Për finalizimin e dokumentit, para aprovimit final, ky draft-dokument shpallet në diskutim publik për **15 ditë** para qytetarëve dhe të gjitha palëve të tjera të interesuara që preken nga zhvillimi i qytetit në tetë (8) vitet e ardhshme.

-Komuna është e përkushtuar të bashkëpunojë ngushtë me të gjitha palët e interesuara që janë të gatshëm të kontribuojnë në përgatitjen e një dokumenti të qëndrueshëm dhe lehtë të zbatueshëm, prandaj ju ftojmë të jeni pjesë e këtij shqyrtimi dhe diskutimi publik, ku pjesëmarrja dhe kontributi juaj do të mundësojë një planifikim të mirëfilltë duke ndikuar direkt në përmirsimin e jetës dhe krijimin e mundësive të reja në komunën tonë.

Dokumentin mund ta gjeni në linkun : <https://app.insi-ks.com/>

-Diskutimi publik do të zgjas **15 ditë nga data 26.12.2023 deri 09.01.2024**, ku të gjithë të interesuarit mund të japin komente, propozime, sugjerime ose vërejtje, të cilat do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe me korrektësi të plotë nga anëtarët e grupit punues në bashkëpunim me kompaninë konsulente “**INSI**” SH.P.K.

-Komentet mund të dorëzohen në mënyrë fizike në **Drejtorinë e Planifikimit Urban** apo edhe përmes formës elektronike në linkun e PZHK në web faqen e komunës ose në email: parayll.zogjani@rks-gov.net

Kryetari i Komunës : Burim Berisha

Faqe 1 nga 1

Komuna e Fushë-Kosovës, Drejtoria për Arsim

Adresa : Rruga : “Tahir Zemaj”, Nr : 2, 12000, Fushë Kosovë-R.e.Kosovës

Telefon: 038/ 200 40 528 , <http://kk.rks-gov.net/fushekosove>

